Vështirësia më e madhe që mund ti bie një njeriu në dynja është vdekja dhe ajo që vijon, nëse fundi i njeriut nuk është xheneti. Andaj besimtari duhet të përgatitet për vdekjen dhe atë që pason kur ka shëndet me devotshmëri dhe vepra të mira.

All-llahu, azze ve xhel-le, ka thënë:

?? ???? ????? ????? ????? ???? ?????? ??? ?? ???? ??? ?????? ???? ?? ???? ???? ??? ?????? ??? ?????? ?????? ???? ???? ??????? ?????? ????? ?? ????????

"O ju që besuat, kini parasysh frikën ndaj All-llahut dhe le të shikojë njeriu se çka ka bërë për nesër, dhe kini frikë All-llahun, e s'ka dyshim se All-llahu është që e di në detaje atë që punoni! E mos u bëni si ata që e harruan All-llahun, e All-llahu bëri që ata ta harrojnë vetveten! Të tillët janë ata të prishurit". (El-Hashr: 18- 19).

Ai që përmend All-llahun kur është i shëndoshë dhe në bollëk është përgatitur për takimin me All-llahun, azze ve xhel-le, është përgatitur për vdekjen dhe atë që pason. Atëherë All-llahu e përmend kur të është ngushtë dhe në vështirësi e është me te, me Butësinë, ndihmën, kujdesin dhe përforcimin e tij në Tevhid. Takohet me All-llahun, kurse All-llahu është i kënaqur me te. Kurse ai që e harron All-llahun kur ka shëndet dhe kur është në bollëk, ai nuk është përgaditur për takimin me All-llahun, andaj edhe All-llahu e harron në këto vështirësi që i biejnë mbi kokë. Domethënë e braktisë dhe e neglizhon.

Kur t'i vjen vdekja, besimtarit që është i përgatitur për te dhe ka mendim të mirë për Zotin e vet, atij i vijnë myzhde nga All-llahu, andaj edhe e dëshiron takimin me All-llahu, por edhe All-llahu e do takimin me te. Kurse e kundërta ndodh me njeriun e prishur. Në këto momente dhe çaste gëzohet besimtari me këtë myzhde që i vjen, kurse ai që s'ka punuar pendohet e thotë:

Phoca PDF

?? ????? ??? ?? ???? ?? ??? ????

"…O i mjeri unë që kam lënë mangët respektimin ndaj All-llahut dhe që kam qenë prej atyre që talleshin!" (Ez-Zumer: 56).

Ebu Abdurahman Sulemiu para se të vdes ka thënë:

??? ?? ???? ??? ??? ??? ?? ?????? ?????

"Si mos të kemë shpresë në Zotin tim, kur për Te kam agjëruar tetëdhjetë ramazane".

Ebu Bekër ibën Ajashi, rahimehull-llah, në prag të vdekjes i ka thënë djalit të tij:

???? ???? ???? ????? ?????? ??? ???? ?????? ?? ????

"A mendon se All-llahu ka për t'ia humbur babës tënde katërdhjetë vitet ku për çdo natë bënte hatme Kur'anin".

Adem ibnë Ijasi e bëri hatme Kur'anin në prag të vdekjes, pastaj tha:

???? ?? ??? ???? ?? ?? ??? ?????? ??? ???? ???? ????? ??? ????? ?? ??? ??? ????

"Për dashurinë që kam pas ndaj Teje ji i Butë ndaj meje në këtë moment dhe në këto vështirësi. Kam pas shpresa të mëdha te Ti për këtë ditë, la ilahe il-lall-llah". Pastaj vdiq.

Kur i erdhi vdekja Zekerija ibën Adijut i ngriti duart e tha:

????? ??? ???? ??????

"All-llahu im, më ka marrë malli për ty".

Katadeja, rahimehull-llah, duke komentuar ajetin kuranor:

??? ??? ???? ???? ?? ?????

"Ai që ka frikë All-llahun, ai atij i jep rrugëdalje". (Talakujtk: 2), thotë:

Rrugëdalje nga vështirësia gjatë vdekjes.

Kurse Ibën Abasi, radijall-llahu anhu, ka thënë:

I jep rrugëdalje nga çdo vështirësi në dynja dhe ahiret.

Zejd ibën Eslemi duke komentuar ajetin kuranor:

?? ????? ????? ???? ???? ?? ???????? ????? ????? ???????? ?? ?? ?????? ?????????

Phoca PDF

"E, s'ka dyshim se ata që thanë: "All-llahu është Zoti ynë", dhe ishin të paluhatshëm, atyre u vijnë engjëjt (në prag të vdekjes dhe u thonë): të mos u frikësoheni, të mos pikëlloheni, keni myzhde xhenetin që u premtohej". (Fussilet: 30).

Kjo myzhde i vjen gjatë vdekjes, në varr dhe kur të ringjallet. Ai do të arrij në xhenet, mirëpo lezeti dhe gëzimi i kësaj myzhde nuk do të zhduket nga zemra e tij.

Thabit Bunaniu, rahimehull-llah, thotë:

Kemi mësuar se kur të ringjallet besimtari nga varri takohet me dy melaqe, të cilët kanë qenë me te në dynja e i thonë: mos ke frikë dhe mos u mërzit. Atëherë All-llahu e siguron nga frika dhe i jep kënaqësi. Në këtë ditë kur shumë njerëz alivanosen nga vështirësia e kësaj dite, besimtari është në kënaqësi i sigurt, për shkak të udhëzimit të All-llahut dhe veprave të tija të mira që i ka bërë në dynja. (Shiko: "Xhamiul-Ulumi Vel-Hikemi", 1/472- 477).

Bekir Halimi

mesoislamin.com

Phoca PDF